



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL¹

(I përmbledhur)

Tiranë, më 06.08.2019, ora 09.30

Drejton mbledhjen

Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit

Rendi i Ditës :

1. Shqyrtimi i gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidatës Marsida Xhaferllari, kandidate për vendin vakante në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019 dhe për vendin të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

2. Diskutim dhe vendimmarrje lidhur me gjendjen që rezulton nga procedura e verifikimit të kandidaturave dhe numri i kandidatëve të lejuar, si edhe për mënyrën e procedimit nga ana e Këshillit, për vendet vakante si më poshtë:

- vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë

- vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018

- vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, shpallur nga Kuvendi në datën 28.08.2018

Marrin pjesë :

- | | |
|---------------------|---------------------|
| 1. Ardian Dvorani | (kryetar) |
| 2. Vitore Tusha | (zëvendës kryetare) |
| 3. Arta Marku | (anëtare) |
| 4. Fatri Islamaj | (anëtar) |
| 5. Margarita Buhali | (anëtare) |
| 6. Fatjona Memçaj | (anëtar) |
| 7. Eriol Roshi | (anëtar) |

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike qëndrimet dhe diskutimet e plota të vetë anëtarëve të KED, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :

1. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.

HAPET MBLEDHJA

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, deklaron të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

Ardian Dvorani lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

Shqyrtimi i gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidatës Marsida Xhaferllari, kandidate për vendin vakante në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019 dhe për vendin të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Diskutim dhe vendimmarrje lidhur me gjendjen që rezulton nga procedura e verifikimit të kandidaturave dhe numri i kandidatëve të lejuar, si edhe për mënyrën e procedimit nga ana e Këshillit, për vendet vakante si më poshtë:

- vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë

- vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018

- vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, shpallur nga Kuvendi në datën 28.08.2018

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

Anëtarët e Këshillit miratojnë rendin e ditës së programuar.

Këshilli vijon mbledhjen me shqyrtimin e gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidatës Marsida Xhaferllari për kandidimin e saj në një vend vakant në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatores Margarita Buhali të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatës Marsida Xhaferllari.

Margarita Buhali parashtron relatimin për kandidaten Marsida Xhaferllari për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ardian Dvorani, me pëlqimin paraprak të anëtarëve, i kërkon edhe anëtarit relator Fatri Islamaj të relatojë gjetjet për rastin tjetër të kandidimit të kandidates Marsida Xhaferllari.

Fatri Islamaj parashtron relatimin për kandidaten Marsida Xhaferllari për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti me datë 04.03.2019.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Eriol Roshi merr fjalën dhe shprehet se nuk kam pyetje për koleget relatorë, por kam një shqetësim. Nuk e kuptoj pse kandidatja e ngre si shqetësim faktin që ne relatorët dhe Këshilli i është drejtuar organeve ligjzbatuese. A ka ndonjë rast që ne nuk jemi drejtuar në këto organe për vendimin ndalimit apo lejimit dhe i jemi drejtuar vetëm për këtë candidate?

Fatri Islamaj, shpjegon se beson që ju e keni përgjigjen brenda. Ju e dini që nuk ka asnjë rast që të mos i jemi drejtuar. Është procedurë e njëjtë. Ajo që duhet sqaruar edhe me vendim apo edhe për të ftuarit dhe për Avokaten e Popullit, është fakti që KED i është drejtuar të gjitha organeve ligjzbatuese si SHISH, SHÇBA dhe agjencive të tjera, të cilat, në fakt, ashtu si për këtë candidate edhe për kandidatët e tjerë, nuk kanë kthyer përgjigje drejtpërdrejtë Këshillit por na e kanë kthyer përgjigjen nëpërmjet DSIK-së. Është shqetësim që e ngre kandidatja në prapësimet e veta ku pretendon që pasi është njohur me aktet e dosjes dhe të gjitha shkresat e Këshillit, konstaton që Këshilli i është drejtuar këtyre organeve ligjzbatuese në lidhje me verifikimin e figurës dhe integritetit dhe thotë që nuk janë administruar përgjigjet. Aludon ose mendon që mund të ketë përgjigje pozitive. Në fakt nuk ka asnjë përgjigje nga këto agjenci sepse për shkak të mënyrës së mbledhjes, përpunimit dhe komunikimit të informacionit të klasifikuar është bërë e njëjta procedurë, është zbatuar e njëjta procedurë që këto agjenci kanë komunikuar me Këshillin jo drejtpërdrejt por nëpërmjet DSIK-se. Prandaj përgjigja ka ardhur nga DSIK .

Eriol Roshi merr fjalën dhe shprehet se atëherë nuk ka pse e ngre këtë pretendim. Shqetësimi im është parimor sepse kandidatja deklaron që çdo veprim i Këshillit për tju drejtuar drejtpërdrejt agjencive ligjzbatuese e për të nxjerrë të dhëna dyshuese të klasifikuara ndaj meje, është haptazi i paautorizuar nga ligji dhe për këtë shkak është shkelje flagrante e neneve 32 e 35 të Kushtetutës. Shprehjen “në shkelje flagrante” në të gjithë këtu duke qene juristë e kuptojmë çdo të thotë dhe nuk kuptoj tani kemi bërë ndonjë veprim tjetër ne që nuk i jemi drejtuar për kandidatë të tjerë agjencive ligjzbatuese? Nuk e kuptoj?

Ardian Dvorani merr fjalën dhe shpjegon se vlerëson të shprehet vetëm për procesin në tërësi, jo për rastin konkret dhe pa hyrë në pjesën e relatorëve. Një gjë unë di ta them por që në fakt

del nga të gjitha vendimet dhe nga relacionet. Organeve ligjzbatuese i jemi drejtuar me datën 17 prill me shkresa, të cilat janë me dy lista. Pra është lista e kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese dhe lista e kandidatëve për Inspektor i Lartë i Drejtësisë. Janë shkresa me lista dhe jo me emra individuale. I jemi drejtuar edhe KLGJ-së, sepse dëgjova nga relatimi që ka një aludim aty që është për mua. Në datën 19 prill, dy ditë më pas, për të gjithë gjyqtarët dhe ish gjyqtarët, jo individualisht por me listë kandidatësh, duke i kërkuar, si të thuash praktikisht një dosje të plotë, emërimi, karriera, nëse ka masë disiplinore, nëse ka vlerësime profesionale, nëse ka aplikime për promovim sidomos për gjykata të posaçme etj. etj. E njëjta gjë është bërë edhe tek KLP për prokurore dhe ish prokurorë, por më duket se vetëm z.Besnik Muçi ishte, nuk e mbaj mend, ka qenë edhe z. Theodhori Sollaku dhe kemi thënë të njëjtën gjë. Na dërgoni informacion të kësaj natyrë. Përgjigjja e KLGJ-së ka ardhur me 25 prill. Në datën 20 maj, meqenëse kuptuam se agjencitë e tjera ligjzbatuese, nuk na u përgjigjen direkt, i jemi drejtuar DSIK-së për ndihmë administrative për ta marrë informacionin. Ata janë përgjigjur sipas listave të emrave që ne kemi çuar. Kaq mund të them. Mund ta konfirmojnë edhe relatorët që nuk ka asgjë ndaj personit konkret, por është një proces standard i aplikuar. Pretendon se është shkelje flagrante, ky është një diskutim tjetër pastaj. Por nuk është një gjë për të personalisht.

Margarita Buhali parashtro se veç asaj që ngrihet për KLGJ-në, ajo ka ngritur pretendimin pse është kërkuar për Gjykatën e Apelit për Krimeve të Rënda dhe jo për apelet e tjera civile. Ngrihet një pretendim i dytë për sa i përket dy shkresave që janë drejtuar ndaj DSIK-së. Është ajo shkresa e parë që është bërë në prill dhe ajo e dyta në maj. Personalisht i kam kërkuar kopje të dyja shkresave dhe lista ishte me të gjithë emrat, sa i përket emrave për listën e kandidatëve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Për sa i përket pjesës tjetër, kandidatja ka ngritur edhe pretendime që për sa i përket informacioneve të kërkuara mbi kontakte të papërshtatshme, kjo nuk hyjn në kuadrin e verifikimit të pastërtisë së figurës sipas ligjit nr.115/2016. Ndoshta është ngritur në kontekstin e gjithë kësaj, pra mbledhja e të dhënave për këto qëllime tejkalon kufijtë që sipas ligjit duhet të ketë KED në verifikimin e figurës së integritetit të kandidatit. Pra është ngritur për mënyrën e procedurës së ndjekur.

Fatri Islamaj merr fjalën dhe parashtro se dua të plotësoj edhe unë për sa i përket pozicionit të kandidatëve për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese. Veprimi i fundit verifikues që ka kryer Këshilli pas kësaj korrespondence, ka qenë shkresa e datës 05-08-2019 drejtuar DSIK-së lidhur me raportin që ky institucion ka bërë për llogari të KPK. Edhe ky raport na është vënë në dispozicion me datë 05-08-2019, bashkë me shkresën përcjellëse. Është dy faqe, ku na rezulton nga ky raport që për këtë kandidatë nuk administrohen prova apo informacione të tjera nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar

ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Pra përcakton përshtatshmërinë për vijimin e detyrës. Ky raport është i vitit 2017.

Vitore Tusha merr fjalën dhe shprehet se pyetjen që ngriti Erioli unë e shikoj si çështje edhe për Këshillin. E krahasuar me atë veprimtari që Këshilli ka bërë konkretisht për çështje konkrete, duke nisur nga çështjet që ka prezantuar në të gjithë shkresat kandidatja, unë i kam grupuar këto çështje kryesisht në kontekstin e veprimtarisë së Këshillit, kontekstin e veprimtarisë së organeve të tjera ligjzbatuese dhe më pas kërkon fshirjen, detyrimin për tu njohur me faktet për të cilat ka këtë problematikë dhe në fund na kërkon fshirjen e të dhënave. Këto janë grupi i çështjeve të mëdha. Duke iu bashkuar çështjes që ngre Erioli mendoj që jo vetëm këto janë çështje që ne do ti diskutojmë në vendimmarrje, por duhet të pasqyrohen dhe të gjejnë si problematika vend në vendimin tonë, për ti dhënë përgjigje pa venë në dyshim fare që nuk ka asnjë procedure të avancuar, diskriminuese në raport me kandidaten, sikur ajo e ka vlerësuar. Siç u tha edhe nga relatorët dhe nga kryetari, për secilin kandidat janë bërë kërkime të njëjta, uniforme, të pasqyruara në të njëjtat shkresa dhe më pas është e drejtë procedurale që kur për dikë ka disa të dhëna të ndryshme, të vazhdojë të avancojë procedura me kërkesa për tu sqaruar çështjet. Në këtë drejtim ka qenë vazhdimi i procedurës deri në momentin e fundit, pavarësisht që mundet organet ligjzbatuese të kishin qenë pak më shumë bashkëpunuese në këtë rast. Sepse nuk është bashkëpunim të na i sjellin pas një muaji. Por ato e dinë më mirë se ne rastin, pasi është i njëjti institucion që kanë nxjerrë dy akte të ndryshme dhe mundet që në përputhje me ligjin të na parashtronin edhe diçka për përmbajtjen, diçka me tepër jo si kuriozitate për faktin por kanë detyrimin sipas meje ose të na informonte se vazhdoj ta kem në vëzhgim ose vazhdoj të kem problematika dhe nuk të jap asgjë më shumë ose të thoshte ka ndodhur dikur dhe çfarë është bërë me këtë gjë. Ka afate, pra ka disa rregulla edhe këto organe mbi të cilat e vendosin dhe e zhvillojnë veprimtarinë e tyre, cilido të ishte rasti. Por duke qëndruar tek rasti i veprimtarisë së Këshillit mendoj që, jo se nuk e di, ka dashur ti evidentojë, i intereson ti evidentojë të gjitha. Mendoj se nuk ka asnjë lloj cedimi nga Këshilli në këtë veprimtari për këtë kandidatë dhe për asnjë kandidat.

Erinda Ballanca, merr fjalën për të shtruar disa pyetje. A ka pasur hetime të mëtejshme për rastin në fjalë sepse nga relacioni me rezulton se është marre një shkresë nga ana e prokurorisë në lidhje me personin në fjalë për sa i përket problemeve të dënimeve apo hetimeve. A rezulton të ketë pasur hetime të mëtejshme në lidhje me rastin në fjalë që të kenë çuar në një rezultat apo jo sepse të dhënat nga këto organe, në parim, përbëjnë një indice që duhet hetuar me pas?

Margarita Buhali shpjegon se nuk ka asnjë të dhënë të tillë. Sipas shkresës së prokurorisë kandidatja rezulton e pastër. Të paktën nuk jemi njoftuar as për hetime që të kenë ndodhur mbi këto informacione.

Erinda Ballanca, merr fjalën dhe shtron pyetjen tjetër. Duke qene se unë jam njohur pjesërisht me dokumentacionin, për ato që kanë qenë të deklasifikuar e kam fjalën, a ka të dhëna konkrete për rastin, pra a ka ndonjë të dhënë konkrete e cila të çojë në ekzistencën e një problematike konkrete apo vazhdon të mbetet e gjitha në ato që janë të deklasifikuara?

Margarita Buhali shpjegon se nuk ka asnjë të dhënë konkrete për secilin nga rastet e referuara.

Erinda Ballanca, merr fjalën dhe shtron pyetjen tjetër. Nga relatimi, nga pretendimet e palës dhe nga faktet njohura publike, rezulton se kandidatja ka kaluar dhe të gjithë procedurën e procesit të verifikimit në KPK i cili ka dalë me një vendimmarrje pa një rezultat përfundimtar për sa i përket konfirmimit të detyrë, me arsyetimin se nuk ka statusin e gjyqtarit. Pavarësisht kësaj, ka rezultat sipas vendimmarrjen në lidhje me një raport i cili pretendohet të jetë paraqitur nga ana e KPK? A keni pyetur ju nëse i njëjti pretendim i cili ngrihet në rastin konkret apo të njëjtat të dhëna apo të njëjtat fakte janë paraqitur edhe në raportin e bërë në kuadër të procedurës së vlerësimit kalimtar të të kandidates?

Fatri Islamaj shpjegon se ky ishte në sqarimin e fundit që bëra, pikërisht duke pasur parasysh këtë pikëpyetje, duke e çmuar që është element i rëndësishëm e që duhet sqaruar nga Këshilli. Relatorët kane versuar që të marrin komunikimin që institucioni i posaçëm, pra DSIK ka pasur me KPK gjatë procedurës së vlerësimit të kësaj kandidate gjatë kohës që ka qenë në proces vlerësimi. Na është paraqitur raporti që është depozituar KPK-së nga DSIK siç citova edhe përmbajtjen. Në fakt citova përmbajtjen e pikës “b”, por edhe pika “a” thotë Marsida Xhaferllari ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete. Pika 3 është konkluzioni që konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit. DSIK na ka vënë e në dispozicion sepse e kemi kërkuar posaçërisht nga ky institucion i posaçëm i menaxhimit dhe mbledhjes së të dhënave të klasifikuara për komunikimin që ka pasur me KPK.

Erinda Ballanca, merr fjalën dhe shtron pyetjen tjetër. A e ka hetuar KPK këtë problematike? Sepse mundet ta hetojë dhe të dali që nuk ka probleme. Ka pasur disa raste në të cilat vetë KPK ka hetuar në lidhje me indiciet dhe ka ardhur në konkluzion. Nuk e di se çfarë ka ndryshuar nga raporti i KPK deri tani, por kjo i takon përgjegjësisë së institucionit, edhe në vlerësimin e seriozitetin e punës që secili prej nesh duhet të ketë, besoj se kjo është shume e rëndësishme që ato nuk mund të dërgojnë raport të ndryshme në kohë të ndryshme, në organe të ndryshme. Duhet të mbajnë përgjegjësitë përkatëse sepse o ka ekzistuar më parë është fshehur ose nuk ka ekzistuar asnjëherë. Pse e them këtë sepse mund të na dali brenda ditës për secilin prej nesh kjo pyetje. E vëmë veten në vetë të parë. Sa herë duhet të verifikohemi për të qenë të pastër për të njëjtën periudhe sepse unë e kuptoj që nga momenti që është bërë ky raport dhe është paraqitur në

KPK apo nga momenti që janë marrë 5 certifikatë sigurie, a mund të them më se mund të ketë ndonjë problematike. Por ne momentin që çdo kush prej nesh mendon se është verifikuar dhe ka një certifikatë që është i pastër deri në momentin e daljes se certifikatës, jo një here por katër pesë herë, nuk mundet t' mendoj që mund ti dalë ndonjë problem i tillë. Nga ky fakt mendoj ka ardhur dhe shqetësimi dhe komunikimi i zonjës kandidate, duke pasur këto lloj pretendime ose ngritjen e këtyre lloj pikëpyetjesh në gjykimin tim, sepse me duket një gjë tërësisht absurde sa më takon mua në kuadër të mbrojtje të drejtave të njeriut.

Ardian Dvorani duke i ndërprerë fjalën, shprehet se në këtë pikë, ne shqyrtojmë gjetjet për kandidaten por nuk kemi kompetenca dhe mision të analizojmë mënyrën se si e ushtrojnë veprimtarinë organet ligjzbatuese. Nuk e kemi të drejte të themi pse njëherë ishte informacioni pozitiv dhe një herë negativ. Nuk kemi as të drejtën që të themi kjo ka vlerë e kjo nuk ka vlerë ose kundërta kjo nuk ka vlerë dhe kjo ka vlerë. Ajo që është e dukshme është se ka dy raporte që janë krejt të ndryshëm nga njeri tjetri, si ka ndodhur unë nuk e di. Por sigurisht është një gjë që nuk na takon ne të shprehemi, nuk është pjese e analizës dhe vendimmarrjes sonë. Faktin e pasqyrojmë që ka dy dhe janë raportime të kundërta, por jo që të bëjmë analizën e tyre që pse ka ndodhur kjo gjë. Ne thjesht e konstatojmë dhe mbajmë qëndrimin tonë për kandidaten ashtu si e mendojmë ne. Për këtë të ndërpreva. Ajo që thatë mundet është vërtete shqetësim por nuk jemi ne që ta evidentojmë këtë. Nuk ka lidhje. Në rastin konkret marrim vendimin që ne mendojmë ta marrim por pa bërë analizën e organit tjetër sepse ne nuk e dimë. E kupton? Mund ta thoni lirisht por të paktën ne si autoritet dalim jashtë kompetencës sonë nëse shprehemi për këtë.

Erinda Ballanca, vijon fjalën dhe shprehet se disa nga kërkimet që ka bërë kandidatja në lidhje me fshirjen e të dhënave etj. e kuptoj që nuk janë pjese e objektit të Këshillit. Por ajo që unë sigurisht kërkoj dhe secili prej nesh duhet të pretendojë dhe këtë gjë mundet mos ta bëjmë me vendimmarrje por sigurisht mund ta bëjmë duke mbajtur një qëndrim të caktuar në lidhje me këtë çështje edhe në kuadër të relatimit është që ky organ duhet të jetë shumë i përgjegjshëm kur lëshon këto dokumente. Unë po te isha kandidate nuk do e lija me kaq sepse është e pamundur që njerëzit të fshihen pas gishtit. Ka një përgjegjshmëri tek secili organ për kryerjen e detyrave të tyre që u ka dhënë ligji dhe akoma më të lartë kur verifikojnë këto kandidate për këto pozicione kaq të rëndësishme. Siç e shikoj unë nivelin e përgjegjshmërisë si individ dhe si Avokate e Popullit secili prej nesh kur jep një qëndrim duhet të jetë ai qëndrim i arsyetuar dhe ato gjetjet sigurisht duhet të jenë të arsyetuara e të trajtuara në mënyrë të plotë dhe shteruese. Sepse kjo vendos pikë së pari në pikëpyetje institucionin, përtej besueshmërisë së themelit apo qëndrimit. Një institucion që parqet të dhëna të tilla kontradiktore për të njëjtin kandidat, pesë herë të dhëna të tjera dhe një herë ndryshe. Ekzistenca e certifikatave të sigurisë të lëshuara nga institucion për këtë person gjatë gjithë këtyre

viteve nuk do të duhet të kishin lënë asnjë lloj dyshimi në lidhje me këtë pjesë, të paktën. Aq më tepër që i përket një periudhe shumë të largët. Duhet të jap qëndrimin? Nga relatimi që u bë çështjes dhe dokumentet të cilat ishin të deklasifikuara dhe që u morën në shqyrtim nga ana ime dhe nga përgjigjet e pyetjeve të relatorëve konsideroj që nuk ka shkak për të ndaluar kandidaturën e znj. Marsida Xhaferllari qoftë në pozicionin e Inspektorese së Lartë të Drejtësisë dhe atë të Gjykatës Kushtetuese.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, orienton vijimin e mbledhjes me pikën tjetër të rendit të ditës dhe pastaj me ndonjë çështje organizative. Fillimisht në lidhje me problematikën e ecurisë së procedurave për tre nga vendet vakante.

Ardian Dvorani, në cilësinë e relatorit të vendit vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, shpallur nga Kuvendi në datën 28.08.2019, parashtron se për këtë vend vakant aktualisht nuk ka mbetur asnjë kandidat. Edhe nëse presim procesin e ankimimit, meqenëse janë 3 kandidatë të ndaluar, do të ishte krejt formale sepse rasti i kandidatës Valbona Bala është një rast që nuk zgjidhje tjetër. Ka një vendim të Kolegjit të Posaçëm që është përfundimtar dhe në çdo rast, sipas gjykimit tim, përjashton çdo mundësi që të ketë hapësirë kandidimi, edhe në kandidatja do ti drejtohej gjykatës administrative. Pra do të ishte thjesht një humbje kohe pritja formale në këtë rast edhe për procedura e mundshme të ankimimit nga kandidati Sinan Tafaj dhe Fiona Papajorgji. Në rastin e kandidatës Papajorgji, e ndalua kandidimin sepse nuk plotësonte vjetërsinë vetëm në këtë vakancë, dhe kjo nuk është çështje procedure, por është çështje e interpretimit të ligjit. Në rastin e zotit Tafaj, edhe pas konsiderimit të një pjese të pretendimeve për pasurinë, përsëri ishin dy, tre momente në të cilën ai nuk kishte respektuar ligjin dhe në vendosëm ndalimin e kandidimit. Ne i kemi dhënë çdo lloj aksesi dhe mundësie dhe nuk ka formalisht motive për tu pranuar në rast ankimi. Gjithsesi edhe vetë rasti i zonjës Bala e bën këtë pozicion vakant absolutisht të pamundur që të ketë 3 kandidatë. Prandaj, si relator do ti propozoja Këshillit të marrë vendim që të njoftojmë organin e emërtesës, Kuvendin, lidhur me këtë situatë dhe pastaj sigurisht është në çmimin atyre si do të veprojnë. KED vetëm për pozicionin e Inspektorit është kompetent për të vendosur kurse organet e tjera të emërtesës vetëm i informojmë.

Erinda Ballanca merr fjalën dhe shprehet se pikëpyetja ime ka të bëjë me faktin nëse dhe formalisht zbatohet afati i të drejtës së ankimit, nga momenti i komunikimit të vendimeve, është për çështje procedurale më tepër. Pra që të konsiderohet se e kanë pasur një të drejtë efektive ankimi. Pra, nuk është se ndryshon dërgimi i njoftimit tani apo pas një afati 5 ditor.

Ardian Dvorani shpjegon se në këtë mënyrë do të shkonim në fundin e muajit për vendimmarrje. Gjithsesi këtë doja të evidentoja, është një pozicion që nuk ka asnjë mundësi, asnjë

skënar që të ribëhet me tre kandidatë. E dyta, nuk është problemi jonë se si vepron Kuvendi, kur e shpall, kur e rishpall, as të gjykoj janë të mbyllur punimet etj. Ky nuk është problemi jonë.

Bledar Dervishaj kërkon fjalën dhe shprehet se për veprimtarinë e Kuvendit ka të drejtë Avokatja e Popullit. Në momentin që shkresa juaj do të merret si një konstatim i vakancës, ashtu sikur edhe ne sikur na njofton gjykata kushtetuese, duhet të shpallin vakancën brenda 7 ditëve. Ashtu sikundër është për tu pyetur veten Këshillin njoftuar vendimet e arsyetuara kandidatëve që janë skualifikuar në mënyrë që të shkojnë paralel këto, të paktën subjektivisht. Mos shkojë njoftimi për Kuvendin përpara njoftimit të kandidatit vetëm për vendimet dhe për të drejtën e ankimit që i lind nga rregullorja mbas njohjes me vendimin e arsyetuar.

Erinda Ballanca shtron pyetje, nëse ju i keni përfunduar procedurat për këto tre kandidatë dhe a ia keni komunikuar vendimet e arsyetuara të them kandidatëve?

Ardian Dvorani shpjegon se të gjitha vendimet janë të publikuara në faqen elektronike të KED dhe besoj se i kanë marrë në adresat përkatëse se kemi pasur ndonjë rast në të kaluarën. Një pjesë tjetër di që nisen sot, por nuk është rasti i këtyre kandidatëve. Por kjo procedurë nuk na pengon që të vazhdojmë me vlerësimin e gjendjes kur numri i kandidatëve bie nën minimum. Në këtë rast nuk ka asnjë mundësi edhe teorikisht për të pasur më tre kandidatë. Mund të përmbushim detyrimin e njoftimit edhe duke bashkëlidhur 2-3 vendimet, edhe faktin që është bërë komunikimi i vendimeve.

Vitore Tusha merr fjalën dhe parashtron se njoftimi që është bërë në faqen zyrtare të KED-së, mendoj që nuk mund të konsiderohet njoftim i këtyre kandidatëve për sa i takon fillimin e ecjes së afateve dhe për aq kohë sa ata nuk kanë një kopje vendimi të arsyetuar. Kështu që mendoj se, edhe pse nuk ka asnjë mundësi që kjo vakancë të funksionojë, duhet ta presim edhe për këtë procedurë.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë dhe dakordësohen që të sigurohen për dërgimin e vendimeve të zbardhura të gjithë kandidatëve të ndaluar dhe për të vijuar, sipas rastit, në mbledhjen e ardhshme me diskutimin e mundësisë së vendimmarrjes përkatëse, përfshirë edhe atë për njoftimin e organit të emërtesës, Kuvendit, për të vlerësuar shpalljen e procedurës së aplikimit për këtë vend vakant meqenëse nuk ka më kandidatë të tjerë në konkurim për plotësimin e vakancës.

Në të njëjtën mënyrë do të veprohet edhe me rastet e kandidimeve për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ku numri i kandidatëve të lejuar në asnjë rast nuk mund të jetë më shumë se 4 kandidatë, si edhe për rastet e kandidimeve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, shpallur nga Presidenti në datën 07.02.2019, në të cilën kanë mbetur vetëm dy kandidatë të lejuar për kandidim.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, pasi merr mendimin e anëtarëve për rendin e ditës dhe kohën e mbledhjes së ardhshme, duke u përcaktuar zhvillimi i saj në datën 07.08.2019, në orën 9.00, në thelb, me rend dite shpalljen e fillimit të procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së

kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, përcaktimin e kalendarit të intervistave, caktimin e ekspertëve të gjuhëve të huaja, relatimin e dhe intervistën me kandidatin besnik Muçi, deklararon mbylljen e mbledhjes.

MBLEDHJA MBYLLET NË ORËN 10.45

Sekretare

Redjona MYRTJA

Ermelinda KADIU

Dorina DULAJ

Kryetari

Ardian DVORANI